



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Fier, më __.07.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Furnizim-Vendosje e sinjalistikes me ndricim (semafor) ne kryqezimet kryesore te infrastruktures rrugore te qytetit te Fierit”, me burim financimi nga Buxheti i Bashkisë Fier

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

34996100-6 - semafor

45316212-4-instalime te semaforeve

VLERA E FONDIT LIMIT TOTAL : 26 854 674 (njetzet e gjashte milion e teteqind e pesedhjetë e kater mije e gjashteqind e shtatedhjetë e kater) lekë pa TVSH ose **fondi limit në Euro (sipas kursit të këmbimit nga BSH datë 14.07.2026): 286 510.98 (dyqind e tetedhjetë e gjashtë mije e pesëqind e dhjetë pike nentëdhjetë e tete) Euro**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Fier ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilën është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës nr.9

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar në nenin 76 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me License të kategorisë N.S-5, kategoria A (Impiante të sinjalistikës ndricuese të trafikut).

Argumentimi: Ky kriter është i përcaktuar bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, në nenin 41 pika 4, gërma “a”, të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”. Gjithashtu ky kriter bazohet dhe në nenin 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Është në të drejtën e Autoritetit Kontraktor të kërkojë garanci për realizimin me sukses të projektit, duke përfshirë kërkesat për certifikime dhe kualifikime sipas objektit të prokurimit, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, lidhja 3 “Shpjegime për kategoritë e ndërtimeve (punimeve) të përgjithshme”, kategoritë ndahen sipas lidhja 4 “Klasifikimi paraprak i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi dhe preventivit të bazës materiale, Stafit i inxhinierëve të licencuar bazuar në Vendim nr. 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudit të

punimeve të zbatimit në ndërtim” (ndryshuar me vkm nr.943, datë 28.12.2016), I ndryshuar dhe preventivit të bazes materiale.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të çertifikuara të balanceve të 2 (dy) viteve të fundit (**2024, 2025**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 *”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”* i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqërohet me akt-ekspertizën e kryer nga eksperti kontabel.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 4. *Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy balance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit¹.* Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në ligjin nr.25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK. Kriteri i mësipërm është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

2.2.2. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (**2024, 2025**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më pak se **50 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se dyfishi i vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare

konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*; në pikën 1 dhe pikën 2/a të nenit 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se: Pika 1. *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontratën, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.* Pika 2/a: *2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;*

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën sic është parashikuar nga AK. Kriteri i mesipër është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/a e nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë, përfshirë; Pika 2/a: *2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;* Duke qenë se kjo procedurë prokurimi është bazuar në vlerën e fondit limit mbi kufirin e lartë monetar, AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara me pare gjykon se është e përshtatshme vendosja e kriterit të marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik .

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontratën, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;*, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore të ardhurave; Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të

kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, *kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit*. Në këtë rast vlera e kërkuar është jo më pak se **10 000 000 leke pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët Ekonomik duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me një ent publik, si dëshmi pranohen Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku shënohen vlera, afati I perfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara ose vetëm Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku shënohen vlera, afati I perfundimit të kontratës ose vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 4 të nenit 40 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosija e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë teknike të OE ofertues, duke

vertetuar nepermjet pervojes se meparshme, se zoterojne kapacitet dhe aftesine teknike per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

2.3.2 Stafi kryesor e mbështetës, certifikimet, punonjësit e kualifikuar per keto punime.

a) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në përbërje të stafit si drejtues teknik të shoqërisë ose me kontratë pune **Inxhinier elektrik ose elektronik minimumi 1 (një).**

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues dhe **në listë pagesën e shoqërisë** për të paktën periudhën **Qershor 2026**. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, kontratë individuale pune (*e vlefshme*).

b) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij ose me kontratë individuale pune (e vlefshme) për periudhën e realizimit të kontratës të punësuar 1 (një) punonjës që të disponojë çertifikatë/dëshmi si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** në përputhje me klauzolat e ligjit nr.10 237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr.312, datë 05.05.2010, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Për punonjesin e sipërcituar duhet të paraqitet dëshmi/çertifikatë ose çdo dokument tjetër që vërteton diplomimin apo kualifikimin e tij, kontratë individuale pune (e vlefshme) për të paktën periudhën e parashikuar të zbatimit të punimeve.

Shënim: Për pikën **2.3.2** më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në pikën **2.3.2**, duke dorezuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 41, pika 4/b, nenin 56, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshur ,Stafi iinxhinierëve te licencuar bazuar ne Vendim nr. 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” (*ndryshuar me vkm nr.943, datë 28.12.2016*) , dhe preventivit te bazes materiale.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Shenim: Bazuar në nenin 36 të ligjit nr.16 datë 23.012.2020 “Per prokurimin publik” për çdo standart ose emertim marke të përmendur pranohet dhe ekuivalenti i tyre. Kriteret teknike të kualifikimit janë hartuar nga specialisti i fushës.

Hartimi dhe argumentimi i specifikimeve teknike, identifikimi i nevojës për vendosjen e sinjalistikes rrugore vertikale (semaforeve), testimi i tregut dhe përllogaritja e fondit limit, si dhe hartimi dhe argumentimi i kërkesave të veçanta për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik për zhvillimin e procedurës së prokurimit publik janë të hartuara nga Grupi i Punës i ngritur nga titullari i autoritetit kontraktor, Bashkia Fier, me Urdhërin nr.4781 prot., datë 22.04.2026 dhe nr.7167 prot., datë 04.06.2026, me Urdhërin nr.7111 prot., datë 03.06.2026, derguar me shkresën nr.7163 prot., datë 04.06.2026 me lende “Percjellje dokumentacioni” dhe në materialin e derguar me nr.8665/1 prot., datë 02.07.2026 me lende “Dergim dokumentacioni” në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike gjenden pjesë përberëse të DST në SPE

Njësia e prokurimit :